



**QYTETARI NË  
REND TË PARË**

**SI TË ARRIHEN DERI  
TE E-INFORMACIONE  
NGA VETËQEVERISJA  
LOKALE?**



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian  
dhe bashkë-financuar nga Ambasada Britanike Shkup



**ALKA**



## Hyrje

**D**isa nga parimet themelore të qeverisjes demokratike në nivel lokal janë të qenët të hapur dhe pjesëmarrja. Qytetarët kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat me karakter publik që i posedojnë institucionet publike.

Duke i ndjekur përvojat ndërkombëtare, ku qytetarët kanë një rol qendror në institucione, projekti “Qytetari në rend të parë” ka për qëllim të ndikojë në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së vetëqeverisjes lokale, duke siguruar qasje të plotë në të dhënat publike dhe informacionet nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne.


Nuk mjafton më që vetëqeverisjet lokale t'i praktikojnë vetëm mjetet konvencio-

nale të komunikimit me qytetarë, sipas të cilit qytetarët duhet të shkojnë në sportelet dhe të kërkojnë informacione ose shërbime. Sot, qytetarët presin të gjitha informatat të marrin përmes internetit, pra sipas kësaj vetëqeverisjet lokale duhet të jenë më proaktive dhe t'i publikojnë të gjitha informatat relevante në faqet e tyre të internetit që ato të jenë në dispozicion për përdorim nga qytetarët në çdo moment.

Mënyra e tillë proaktive e informimit do t'i bëjë qytetarët më të informuar për të drejtat dhe obligimet e tyre, dhe do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.



## Si i informon komuna qytetarët?




Sipas statuteve të komunave në vend, janë paraparë më shumë mënyra të informimit të qytetarëve, të tilla si:

- ◆ Buletini zyrtar i komunës
- ◆ Publikime dhe buletine informative
- ◆ Zyrat e informacionit/Qendrat
- ◆ Tabelat e shpalljeve (hapësira komunale, ndërmarrjet publike, institucionet dhe vetëqeverisja vendore)
- ◆ Tribuna publike
- ◆ Ueb faqja
- ◆ Mjetet e informimit publik dhe në mënyrë tjetër të përshtatshme që është më e favorshme për informimin e publikut.

Secili prej këtyre mënyrave të parashikuara për informim të qytetarëve kanë pikat e forta dhe dobësitë e tyre, dhe sipas asaj duhet të lejojë praktikimin e qasjeve të ndryshme në mënyrë që informacionet të jenë në dispozicion për kategoritë e ndryshme të qytetarëve.

## Nevoja për digjitalizim më të madh



Vetëqeverisjet lokale janë të detyruara t'i përshtatin dhe ti dizajnojnë shërbimet e tyre në mënyrë që ata do të jenë më të arritshme për qytetarët. Nga ajo se teknologjitë digjitale janë gjithnjë e më të përhapura dhe bëhen pjesë e jetës së përditshme të qytetarëve, është e domosdoshme për vetëqeverisjet lokale ta shfrytëzojnë këtë potencial dhe në mënyrë inovative ta ndryshojnë mënyrën e informimit dhe shërbimit të qytetarëve.

Digjitalizimi i vetëqeverisjeve lokale do të mundësonte:

- ◆ qasje e vazhdueshme deri te informacionet nga shtëpia, duke i bërë shërbimet dhe informacionet më të arritshme për qytetarët
- ◆ i lënë hapësirë qytetarit për “vetëshërbim” dhe mundësi që komuna në mënyrë elektronike ti shërbejë qytetarët duke siguruar shërbime elektronike
- ◆ e rrit kënaqësinë e konsumatorit dhe në këtë mënyrë i redukton kostot
- ◆ e zvogëlon barrën e administratës dhe e zvogëlon ngarkesën e punës.

Digjitalizimi nuk duhet ti zëvendësojë plotësisht metodat konvencionale të sigurimit të informacioneve dhe shërbimeve për shkak se jo të gjithë qytetarët janë të gatshëm ti përdorin teknologjitë e reja, por të sigurohet një kanal shtesë për qytetarët për të marrë informacione dhe shërbime.

## Çfarë janë të dhënat e hapura?

Të dhënat e hapura të qeverisë janë të gjitha të dhënat që i posedon sektori publik, të publikuara në internet në format të përpunueshëm kompjuterik, të arritshme për të gjithë qytetarët dhe të lira për ti përdorur dhe përpunuar.

Në fakt, kjo është një qasje krejtësisht më radikale në publikimin e informacioneve - publikimin e të dhënave në formën më themelore të papërpunuar, për të cilat nuk ka nevojë për ndonjë kërkesë të veçantë për të pasur qasje tek ato.



Cilët janë ndotësit më të mëdhenj të ajrit? Sa është paga e këshilltarëve në komunë? Sa fëmijë ka në çerdhen më të afërt dhe sa është numri i edukatoreve të cilat kujdesen për fëmijët? Në cilën pjesë të qytetit ka më shumë mundësi të punësohesh? Si shpenzohen paratë e taksave?

Publikimi i të dhënave të hapura cilësore mund të rezultojë në marrjen e thjeshtë të përgjigjeve për këto pyetje.

## Cilat janë përfitimet e të dhënave të hapura?

Publikimi i të dhënave të hapura mund të sigurojë më shumë përfitime:

### Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së sektorit publik dhe kontrolli demokratik

Për shkak se të dhënat publikohen në formë të papërpunuar në atë “të parë”, kjo ua mundëson qytetarëve ti përpunojnë, ti kombinojnë me të dhëna të tjera, dhe në këtë mënyrë të arrijnë deri te njohuritë më të avancuara për punën e institucioneve publike.

Për shembull, përdorimi i të dhënave të kryqëzuara nga buxhetet e më shumë komunave mund të rezultojë në hulumtim se çfarë lloj buxheti kanë në dispozicion komunat sipas rajoneve, ose në cilat fusha investohet më shumë nga komunat.

Transparenca dhe monitorimi i shtuar mbi institucionet e inkurajon përgjegjësinë te institucionet, sepse rritet fuqia e qytetarëve në informimin për politikat publike.



### Efikasiteti i përmirësuar në sektorin publik

Disa hulumtime tregojnë se publikimi i të dhënave të hapura në mënyrë të konsiderueshme i zvogëlon kërkesat për qasje të lirë deri te informatat, dhe kështu zvogëlohet koha që e shpenzon administrata në përgjigjen ndaj kërkesave për informacione të karakterit publik.

Koha e kursyer e administratës në këtë drejtim, mund të përdoret për qëllime të tjera, duke i përmbushur nevojat e ndryshme të qytetarëve në funksionimin e komunës dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

### Efikasitet më i madh në procesin e dhënies së shërbimeve publike mund të arrihet përmes shkëmbimit ndër sektorial të të dhënave, duke siguruar qasje më të shpejtë në informacione.

Përveç kësaj, me përmirësimin e shërbimeve dhe krijimin e transparencës më të madhe, të dhënat e hapura u lejojnë institucioneve publike të identifikojnë kursime të mundshme në sektorët e tyre.

## Përfitimet ekonomike

Qasja më e lehtë në informacione, përmbajtja dhe njohuria, kontribuojnë në zhvillimin e shërbimeve të reja dhe për të krijuar modele të reja biznesi.

Të dhënat e hapura tërheqin investime, e rrisin punësimin, i ndihmojnë sipërmarrësit të gjejnë mundësi të reja biznesi, të përmirësojnë cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve dhe ti përmbushin nevojat lokale.

Nëse, për shembull, hapen të dhënat e orarit të transportit publik brenda një komune, mundet një kompani ICT ti përdor ato të dhëna falas dhe të krijojë aplikacion mobil për transportin publik.

Përveç kësaj, mundësohet një vlerë e shtuar ekonomike përmes krijimit të kompanive të reja dhe vendeve të reja të punës.



## Pjesëmarrja e qytetarëve dhe përfitimet demokratike

Të dhënat e hapura janë një armë e fuqishme në duart e qytetarëve, kur ata i diskutojnë politikat qeveritare. Të dhënat e hapur jo vetëm që shërbejnë për rritjen e transparencës, por edhe për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në hartimin e politikave. Përveç kësaj, qytetarët do të mund lehtë ta vlerësojnë ndikimin e një politike, të hapin debat publik, të nxisin ndryshim dhe ti hartojnë më mirë politikat, për shkak se mund ti bazojnë kërkimet e tyre duke përdorur një gamë të gjerë të të dhënave të papërpunuara.

## Pse cilësia e të dhënave është e rëndësishme?

---

Të dhënat e hapura janë të dizajnuara për përdorim të gjerë. Pavarësisht nëse të dhënat do të përdoren nga programuesit për të bërë aplikacione të reja, sipërmarrësit të shfrytëzojnë mundësi të biznesit apo qytetarët dhe gazetarët ti përdorin për mbikëqyrje më të mirë të autoriteteve lokale, të dhënat e hapura duhet të jenë të lehta për përdorim dhe të kuptueshme.

Publikimi i të dhënave të cilësisë së mirë dhe publikimi i informacioneve të përditësuara është çelësi për të inkurajuar ripërdorimin më të madh.

Përmirësimi i cilësisë mund të kryhet nga korigjimi i gabimit para publikimit dhe sigurimin që të jetë në dispozicion për përdorim. Gabimet e zakonshme janë të dhënat e pasakta, dokumente të të dhënave dopio, të dhëna jo të plota, gabime drejtshkrimore, etj.

Përditësimi i të dhënave të publikuara është shumë i rëndësishëm, sepse nëse të dhënat nuk përditësohen në kohën e duhur, mund të bëhet të parëndësishme për përdoruesit. Për shembull, në qoftë se nuk publikohen të dhëna mbi orarin e ndryshuar të autobusëve, atëherë aplikacioni i përpunuar për transportin publik nuk do të jetë më relevant për përdoruesit.



### Qendra e menaxhimit me ndryshime

Rr. Rajko Zhinzifov nr. 44-1, Shkup  
Tel.+389(0)2 6092-216  
e-mail: info@cup.org.mk  
ueb: www.cup.org.mk



### Qendra për zhvillim të qëndrueshëm - ALKA

Bul. Partizanski odredi nr. 62-1/16, Shkup  
Tel.: + 389(0)2 3214-505  
e-mail: alka@alka.org.mk  
ueb: www.alka.mk



Bashkimi Evropian

Ky publikim është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Qendrës për menaxhim me ndryshime dhe Qendra për zhvillim të qëndrueshëm - ALKA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.



British Embassy  
Skopje

Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Ambasada Britanike Shkup në kuadër të projektit - Qytetari në rend të parë. Pikëpamjet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë gjithmonë pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Projekti - Qytetari në rend të parë - është zbatuar nga Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve në partneritet me Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm - Alka. Bashkëpunëtorë në këtë projekt janë Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministria e Pushtetit Lokal. Projekti është i financuar nga Delegacioni Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhjen e kontraktave (CFCD) dhe i bashkë-financuar nga Ambasada Britanike.

Projekti fokusohet në përmirësimin e transparencës së njërive të vetëqeverisjeve lokale duke vendosur standarde për të dhëna të hapura në nivel lokal me qëllim të përfshirjes më të mirë të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e punës dhe vendimmarrjes nga ana e komunave.